

L I G J
Nr.7804, datë 10.3.1994

PER DHOMAT E TREGTISE DHE TE INDUSTRISE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

V E N D O S I :

Neni 1

Dhomat e tregtisë dhe të industrisë, që në vazhdim do të quhen "dhoma", janë subjekte të së drejtës publike, të pavarura, pa qëllim fitimi, që funksionojnë në territorin e tyre dhe që i shërbejnë nxitjes së tregtisë dhe të industrisë. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre ato mbajnë parasysh interesat ekonomike të tregtarëve, të degëve a sipërmarrjeve të ndryshme. Ato i japin administratës shtetërore mendime ose propozime për çështje që lidhen me mbarëvajtjen e tregtisë e të industrisë.

Neni 2

Dhomat themelohen dhe e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në të gjitha rrethet e vendit. Në një rreth nuk mund të krijohet më shumë se një dhomë.

Neni 3

Janë anëtarë të dhomës:

- a) tregtarët, të cilët sipas ligjit regjistrohen në regjistrin tregtar;
- b) shoqëritë tregtare të themeluara e të regjistruara në përputhje me ligjin nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", dhe ligjin nr.7667, datë 28.1.1993 "Për regjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare";
- c) ndërmarrjet shtetërore që veprojnë në përputhje me ligjin nr.7582, datë 13.7.1992 "Për ndërmarrjet shtetërore";
- ç) përfaqësitë dhe degët e shoqërive tregtare të huaja, të regjistruara në regjistrin tregtar, me seli në territorin ku dhoma ushtron veprimtarinë.

Anëtarësia në dhomë është e detyruar për gjithë personat e përmendur në pikat "a", "b" dhe "c" të këtij neni.

Anëtarësia në dhomë nuk është e detyruar për bujqit individualë, bashkësitë e bujqve privatë, si dhe për komunat e bashkitë që kanë në pronësi të tyre dhe shfrytëzojnë sipërmarrje të ndryshme.

Neni 4

Organet drejtuese të dhomës janë:

- asambleja përfaqësuese dhe presidenti i saj,
- kryesia e dhomës,
- kryetari,
- sekretari i përgjithshëm.

Neni 5

Veprimtaria e dhomës rregullohet në përputhje me dispozitat e këtij ligji, të statutit të

dhomës dhe vendimeve të asamblesë përfaqësuese të saj.

Eshtë në kompetencë të asamblesë përfaqësuese:

1. Përcaktimi i veprimtarisë së dhomës.
2. Miratimi i statutit.
3. Miratimi i akteve të ndryshme për organizimin dhe funksionimin e dhomës.
4. Miratimi i buxhetit vjetor dhe i raportit për llogaritë vjetore.

Neni 6

Anëtarët e asamblesë përfaqësuese dhe presidenti i saj zgjidhen një herë në katër vjet nga bashkësia e anëtarëve të dhomës. Zgjedhjet bëhen me një tur, mbi bazën e listave njëemërore.

Të zgjedhurit janë persona fizikë të autorizuar për të ushtruar të drejtën e votës. Ata duhet të kenë mbushur moshën 20 vjeç, të jenë tregtarë korrektë dhe të mos jenë dënuar për vjedhje, mashtrime apo shkelje të ligjeve fiskale në fuqi.

Neni 7

Asambleja përfaqësuese zgjedh nga gjiri i anëtarëve të saj, një herë në 2 vjet, kryesinë dhe kryetarin e dhomës.

Presidenti thërret vetë ose me kërkesën e kryetarit të dhomës jo më pak se një herë në gjashtë muaj, mbledhjen e përgjithshme të asamblesë përfaqësuese dhe e drejton atë. Ai është gjithashtu i detyruar të thërrasë mbledhjen e përgjithshme të asamblesë përfaqësuese, në rast se kjo kërkohet nga jo më pak se një e treta e anëtarëve të asamblesë.

Neni 8

Sekretari i përgjithshëm zgjidhet nga kryesia e dhomës.

Neni 9

Kryetari dhe sekretari i përgjithshëm përfaqësojnë dhomën në të gjitha aktet juridike e gjyqësore, sipas dispozitave të këtij ligji dhe atyre të caktuara në statut.

Neni 10

Statuti i dhomës duhet të përmbajë statusin e dhomës, fushën e veprimtarisë, detyrat e të drejtat, organizimin, anëtarësimin e detyrueshëm sipas subjekteve, funksionet dhe kompetencat e organeve drejtuese të dhomës, zgjedhjen dhe revokimin e tyre, kuoriumin dhe vlefshmërinë e vendimeve, komisionin e revizionimit, mjetet financiare, kuotizacionin, kontributet, të ardhurat nga veprimtaria e saj, marrëdhëniet me organin mbikqyrës.

Neni 11

Dhomat mund të themelojnë, të administrojnë dhe të subvencionojnë ekspozita e panairë, shkolla tregtare, shkollaprofesionale, kurse për propagandimin e njohurive tregtare e industriale, zyra për etiketimin dhe kontrollin e standardeve e të cilësisë, si dhe çdo veprimtari tjetër që i shërben nxitjes së tregtisë e të industrisë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 12

Eshtë në kompetencën e dhomave lëshimi i certifikatës së origjinës për mallrat shqiptare të eksportit dhe i dëshmimeve të tjera që kërkohen në shkëmbimet ekonomike brenda e jashtë vendit, me përjashtim të rastit kur ligji ua atribuon këto shërbime organeve të tjera të specializuara.

Dhomave u ndalohet të marrin përsipër mbrojtjen e interesave në fushën e politikës sociale dhe të legjislacionit të punës.

Neni 13

Dhoma gëzon statusin e personit juridik.

Neni 14

Dhoma ka buxhetin e saj. Shpenzimet e funksionimit të dhomës mbulohen nga kuotizacionet, nga kontributet e anëtarëve të saj dhe donatorëve vendas e të huaj, nga të ardhurat e shërbimeve të dhomës, që janë në përputhje me aktet përkatëse dhe kushtet e parashikuara në planin buxhetor të dhomës. Buxheti hartohet dhe ndiqet çdo vit sipas parimeve të administrimit financiar rentabël, duke mos cenuar aftësitë paguese të anëtarëve.

Neni 15

Anëtarët e dhomës paguajnë kuotizacionet dhe kontributet. Vlera e kuotizacionit ndryshon për anëtarët e dhomës sipas ndarjes të dhënë në nenin 3. Kontributet ndahen në kontribute bazë të njëjta për të gjithë anëtarët, dhe kontribute të veçanta. Për qindja e të cilave luhatet në funksion të fitimit që ata realizojnë. Vlera e kuotizacioneve dhe kontributeve përcaktohet në statutin e dhomës.

Organet tatimore janë të detyruara t'u komunikojnë dhomave, në bazë të kërkesës së tyre, dokumentet e nevojshme për caktimin e kontributeve.

Neni 16

Dhomat krijojnë bashkimin kombëtar të dhomave të tregtisë dhe të industrisë, që më poshtë do të quhet "bashkimi i dhomave", i cili ka për detyrë mbrojtjen e interesave të tregtisë dhe të industrisë në nivel kombëtar dhe t'i japë administratës qendrore mendime e propozime për nxitjen e industrisë dhe tregtisë si dhe të bashkërendojë punën e dhomave në rrethe dhe marrëdhëniet e tyre me organizmat analogë të vendeve të tjera.

Bashkimi i dhomave është person juridik, subjekt i të drejtës publike, i pavarur dhe pa qëllim fitimi, me seli juridike në Tiranë.

Neni 17

Organet drejtuese të bashkimit të dhomave janë:

- asambleja e përgjithshme dhe presidenti i saj,
- kryesia,
- kryetari,
- sekretari i përgjithshëm.

Neni 18

Pranë bashkimit të dhomave funksionon arbitrazhi i tregtisë së jashtme në përputhje me dispozitat që përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 19

Veprimtaria e bashkimit të dhomave rregullohet në përputhje me dispozitat e këtij ligji, të statutit të bashkimit të dhomave dhe vendimeve të asamblesë së përgjithshme të bashkimit të dhomave.

Është në kompetencë të asamblesë së përgjithshme të bashkimit të dhomave:

1. Përcaktimi dhe miratimi i veprimtarisë së bashkimit të dhomave.
2. Miratimi i statutit.
3. Miratimi i akteve normative për organizimin dhe funksionimin e bashkimit të dhomave.
4. Miratimi i buxhetit vjetor dhe raporti për llogaritë vjetore.

Neni 20

Anëtarët e asamblesë së përgjithshme të bashkimit të dhomave dhe presidenti i saj zgjidhen një herë në katër vjet nga përfaqësuesit e dhomave të tregtisë dhe të industrisë në rrethe.

Zgjedhjet bëhen me një tur mbi bazën e listave njëemërore. Në asamble çdo dhomë përfaqësohet me numër të barabartë anëtarësh.

Neni 21

Asambleja e përgjithshme e bashkimit të dhomave zgjedh nga gjiri i anëtarëve të saj njëherë në dy vjet kryesinë dhe kryetarin.

Presidenti i asamblesë së përgjithshme vetë ose me kërkesën e kryetarit të bashkimit të dhomave thërret jo më pak se një herë në gjashtë muaj mbledhjen e asamblesë së përgjithshme të bashkimit të dhomave dhe e drejton atë. Ai është i detyruar ta thërrasë mbledhjen edhe në rast se ajo kërkohet nga jo më pak se një e treta e anëtarëve të asamblesë së përgjithshme

Neni 22

Sekretari i përgjithshëm i bashkimit të dhomave zgjidhet nga kryesia e këtij bashkimi.

Neni 23

Kryetari dhe sekretari i përgjithshëm i bashkimit të dhomave përfaqësojnë bashkimin e dhomave në të gjitha aktet juridike e gjyqësore sipas dispozitave të këtij ligji dhe tyre të caktuara në statut.

Neni 24

Statuti i bashkimit të dhomave duhet të përmbajë:

Statusin e bashkimit të dhomave, fushën e veprimtarisë, detyrat dhe të drejtat, organizimin, anëtarësimin e detyrueshëm, numrin e përfaqësimit të dhomave në asamblenë e bashkimit të dhomave, funksionet dhe kompetencat e organeve drejtuese, zgjedhjen dhe revokimin e tyre, kuoriumin dhe vlefshmërinë e vendimeve, komisionin e revizionimit, mjetet financiare, kuotizacionin, kontributet, të ardhurat nga veprimtaria e saj, marrëdhëniet me dhomat në rrethe si dhe me organin mbikqyrës.

Neni 25

Buxheti i bashkimit të dhomave përbëhet nga kuotizacionet, kontributet që dhomat detyrohen të japin në raport me të ardhurat e tyre, të ardhurat nga donatorët vendas e të huaj, si dhe të ardhurat nga ushtrimi i veprimtarisë së bashkimit të dhomave.

Organet tatimore janë të detyruara t'ia komunikojnë bashkimit të dhomave, në bazë të kërkesës së tij, dokumentet e nevojshme për caktimin e kontributeve.

Neni 26

Organi mbikqyrës i veprimtarisë së dhomave dhe bashkimit të dhomave është Ministria e Industrisë dhe Tregtisë e cila ka për detyrë:

a. Të mbikqyrë respektimin nga dhomat dhe nga bashkimi i dhomave të dispozitave ligjore dhe të akteve të tjera normative që rregullojnë veprimtarinë e tregtisë dhe industrisë.

b. Kontrollon ligjshmërinë e akteve normative të nxjerra nga asambletë e dhomave dhe ajo e bashkimit të dhomave. Kur këto akte nuk janë në përputhje me dispozitat ligjore, organi mbikqyrës brenda 15 ditëve nga nxjerra e tyre i kthen ato për rishqyrtim.

Në qoftë se brenda 15 ditëve organi mbikqyrës nuk shprehet zyrtarisht në lidhje me to, ato konsiderohen se janë në përputhje me dispozitat ligjore.

c. Cakton rregullat procedurale të zgjedhjes së asamblesë së përgjithshme dhe të presidentit të saj, të dhomave dhe të bashkimit të dhomave, deri në miratimin e parë të statutit.

Neni 27

Organi mbikqyrës nxjerr akte lidhur me krijimin dhe shpërndarjen e dhomave, kur kjo lidhet me riorganizimin territorial në Republikën e Shqipërisë.

Neni 28

Përdorimi i emërtimeve që përfshijnë fjalët "dhomë e tregtisë dhe e industrisë", "bashkimi kombëtar i dhomave të Tregtisë dhe të Industrisë" është i rezervuar vetëm për subjektet e së drejtës publike të themeluara sipas dispozitave të këtij ligji.

Me autorizim të titullarit të organit mbikqyrës të dhomës mund të bëhen përjashtime nga masa ndaluese e parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni. Përjashtimet bëhen vetëm kur kemi të bëjmë me favorizimin e shoqatave përfaqësuese të interesave ekonomikë të huaj në Shqipëri, atyre shqiptarë jashtë shtetit ose interesave ekonomikë të përbashkët ndërmjet shqiptarëve dhe të huajve, me kusht që këto shoqata të kenë siguruar paraprakisht miratimin nga ana e autoriteteve përkatëse të shteteve të interesuara.

Autorizimi për përdorimin e emërtimeve të përmendura në këtë nen, nuk u jep statusin e subjektit të së drejtës publike të themeluar sipas këtij ligji, shoqatave që e përfitojnë këtë autorizim.

Neni 29

I ndalohet çdo organi, bashkësi, shoqate ose institucioni tjetër të mbajë emërtimet e përcaktuara në nenin 28, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 30

Kur anëtari i dhomës nuk paguan kuotizacionin e caktuar për të, sipas ndarjes të dhënë në nenin 3 për anëtarësim të detyrueshëm, kryesia e dhomës ka të drejtë ta dënojë atë me gjobë në masën 2 fish të vlerës së kuotizacionit. Për çdo rast përsëritjeje vendoset një gjobë në masën e gjobës së mëparshme e shtuar me 1 fishin e vlerës së kuotizacionit. Brenda 15 ditëve nga dhënia e vendimit të kryesisë së dhomës për dënimin me gjobë për anëtarin që nuk ka paguar kuotizacionin, ky i fundit ka të drejtë të ankohet në gjykatën e rrethit. Vendimi i kësaj gjykate është i formës së prerë.

Organet tatimore të rrethit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet e kryesisë së dhomës për dënimin me gjobë.

Neni 31

Mjetet e ndryshme pasurore që kanë zotëruar dhomat e tregtisë, deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji, u transferohen tërësisht dhomave që krijohen në bazë të këtij ligji.

Ministria e Industrisë dhe e Tregtisë kontrollon zbatimin e këtij neni.

Neni 32

Të gjitha aktet e mëparshme ligjore e nënligjore dhe rregullorja për dhomat e tregtisë, shfuqizohen.

Neni 33

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.802, datë 24.3.1994 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.

